



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:067846
Datë: 27.01.2023
Numri i dokumentit: 03910758

C.nr.199/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari **Betim Behluli**, si dhe më Zyrtarin e Lartë për Bashkëpunim Profesional Visar Morina, në çështjen juridike të paditësit Sh. (H.) M. nga fshati Astrazup, Komuna e Malishevës, të cilin e përfaqëson Av. H. K. nga Malisheva, kundër të paditurve H. M. nga fshati Astrazup, Komuna e Malishevës tani me vendbanim në Prizren Rr. “M. K.” nr..... dhe S. B. me vendbanim në fshatin Doberdalan, Komuna e Suharekës, të cilët i përfaqëson Av. B. K. nga Malisheva, për shkak të njohjes së të drejtës së pronësisë, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit kryesor dhe zbatimit të provave, më **16.01.2023**, merr këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesëpadia e paditësit, **SI E BAZUAR**.

VËRTETOHET se paditësi Sh. (H.) M. nga fshati Astrazup, Komuna e Malishevës, është pronar i parcelës kadastrale nr.**01250-0**, në vendin e quajtur “Fshati - Te Shtëpija”, me kulturë “Arë e kl.5”, në sipërfaqe prej 3359 m² ZK Astrazup, parcelës kadastrale nr.**01252-0**, në vendin e quajtur “Nen Rrugë”, me kulturë “Arë e kl.8”, në sipërfaqe prej 1021 m² ZK Astrazup, parcelës kadastrale nr.**01396-0**, në vendin e quajtur “Ara e Mes-Batallina”, me kulturë “Mal e kl.4”, në sipërfaqe prej 726 m² ZK Astrazup, parcelës kadastrale nr.**01397-0**, në vendin e quajtur “Ara e Mes-Batallina”, me kulturë “Arë e kl.8”, në sipërfaqe prej 1032 m² ZK Astrazup, parcelës kadastrale nr.**01404-0**, në vendin e quajtur “Ara Emes-Ara te Vidhet”, me kulturë “Kullosëe kl.5”, në sipërfaqe prej 250 m² ZK Astrazup, parcelës kadastrale nr.**01405-1**, në vendin e quajtur “Ara Emes-Ara te Vidhet”, me kulturë “Arë e kl.7”, në sipërfaqe prej 3173 m² ZK Astrazup, parcelës kadastrale nr.**01405-2**, në vendin e quajtur “Ara Emes-Ara te Vidhet”, me kulturë “Kullosë e kl.5”, në sipërfaqe prej 6123 m² ZK Astrazup, në bazë të parashkrimit fitues, çka të **paditurit** H. M. dhe S. B., janë të **obliguar** që të pranojnë këtë të drejtë dhe të lejojnë që paditësi të regjistrohet si pronar në regjistrin Kadastral të Pronave pranë Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë në Malishevë, ku si bazë juridike do të shërbejë ky aktgjykim dhe atë në afat prej 15 ditë nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimit të përmbarimit të detyrueshëm.

Shpenzimet procedurale i bartë paditësi.

A r s y e t i m

Paditësi Sh. (H.) M. nga fshati Astrazup, Komuna e Malishevës, përmes të autorizuarit të saj Av. H. K. nga Malisheva ka ushtruar padi kundër të paditurve H. M. nga fshati Astrazup, Komuna e Malishevës tani me vendbanim në Prizren Rr. “Murat Kabashi” nr.25. dhe S. B. me vendbanim në fshatin Doberdalan, Komuna e Suharekës, sipas bazës juridike njohje të së drejtës së pronësisë.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësit i ka njoftuar të paditurit me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi.

Të paditurit përmes përgjigjës në padi kanë deklaruar duke e pohuar kërkesëpadinë e paditësit për faktin se disa vite para luftës këtë paluajtshmëri ia kemi shitur paditësit, ndërsa paditësi të gjitha obligimet lidhur me shitblerjen i ka përmbushur, dhe që nga atëherë janë në posedim dhe shfrytëzim të kësaj paluajtshmërie.

Sipas kësaj çështje juridike gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, në të cilat janë paraqitur i autorizuari i paditësit, Av. H. K. dhe i autorizuari i të paditurve Av. B. K..

I autorizuari i paditësit Av.H. K. ka deklaruar duke mbetur në tërësi pranë kërkesëpadisë dhe padisë së paditësit, paditësi nga të paditurave qysh para 30 viteve i ka blerë parcelat që janë objekt i këtij kontesti dhe që atë kohë i njëjti i ka kryer të gjitha prestatimet, dhe me njëherë ka hyr në shfrytëzim të parcelave që nga ajo kohë. Meqenëse të paditurat me përgjigje në padi nuk e kanë kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë dhe i kanë pohuar pretendimet si në padi, i propozoj gjykatës që të dal në vend së bashku me ekspertin gjeometër dhe të bëjë identifikimin e parcelave, dhe pas administrimit të provave i propozoj gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit të aprovoj si të bazuar, në fjalën përfundimtare ka deklaruar gjykata gjatë gjithë procedurës nga deklaratimet e palëve të paditura dhe pas identifikimit të parcelave kontestuese gjykata mund të vërtetojë faktin se paditësi është pronar faktik i parcelave kontestuese dhe është shfrytëzues i parcelave pa u penguar nga askush që nga koha e shitblerjes e deri më sot, gjithashtu paditësi deklaron se janë përmbushur të gjitha kushtet e marrëveshjes së shitblerjes së parcelave në fjalë, andaj në fund i propozoj gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoi në tërësi si të bazuar,

I autorizuari i të paditurve Av.B. K. ka deklaruar duke mbetur në tërësi pranë përgjigjes në padi të cilat personalisht i kanë parashtruar të paditurat sipas deklaratimeve të tyre janë të vërteta pretendimet si në padi, paditësi është pronar faktik i parcelave që janë objekt i këtij shqyrtimi, nuk i kundërshtoj propozimin që gjykata së bashku të dal në vend për identifikimin e parcelave dhe i propozojnë gjykatës që tia pranojë të drejtën e pronësisë paditësit me kusht që i njëjti ti bart shpenzimet procedurale, në fjalën përfundimtare ka deklaruar duke mbetur në tërësi pranë të gjitha deklaratimeve të dhëna në këtë çështje kontestimore, gjykata deklaratimet tona ka mundur ti vërtetojë edhe në vend se paditësi është pronar i parcelave kontestuese dhe nuk e kundërshtojmë që gjykata ta aprovoi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe paditësi të regjistrohet pranë librave kadastrale si pronar i ligjshëm me kusht që të mos ngarkohen të paditurat me asnjë shpenzim procedural.

Për të vërtetuar faktet vendimtare, gjykata i ka zbatuar këto prova: ka bërë shikimin në certifikatat e pronësisë për parcelën nr.01250-0 të datës 23.03.2021, ZK Astrazup parcelën nr. 01252-0 të datës 23.03.2021 ZK Astrazup, parcelën nr. 01396-0 të datës 23.03.2021 ZK Astrazup, parcelën nr. 01397-0 të datës 23.03.2021 ZK Astrazup, parcelën nr. 01404-0 të datës 23.03.2021 ZK Astrazup, parcelën nr. 01405-1 të datës 23.03.2021 ZK Astrazup, parcelën nr. 01405-2 të datës 23.03.2021 ZK Astrazup si dhe ka bërë shikimin në ekspertizën dhe skicës së terrenit nga G.-1. e datës 16.01.2023.

Pas analizimit dhe vlerësimit të secilës provë veç e veç, duke i vlerësuar në deklaratat e ndërgjyqësve si dhe duke u mbështetur në dispozitën e nenit 7 dhe 8 të LPK-së, në bazë të bindjes së vetë të lirë, është konstatuar se kërkesë padia e paditësit është **e bazuar dhe e njëjta është aprovuar.**

Nga provat të zbatuara është vërtetuar kjo gjendje faktike:

Me shikimin në certifikatat e pronësisë, parcelën nr.01250-0, parcelën nr. 01252-0, parcelën nr. 01396-0, parcelën nr. 01397-0, parcelën nr. 01404-0 , parcelën nr. 01405-1 parcelën nr. 01405-2vërtetohet se ngastrat e lartëcekura evidentohen në emër të të paditurve H. M. dhe S. B..

Me shikimin në ekspertizën dhe skicës së terrenit të kompanisë G.-L. të datës 16.01.2023, është konstatuar se: parcela kontestuese nr.01250-0, në vendin e quajtur “Fshati- Te Shtëpija”, me kulturë “Arë e kl.5”, në sipërfaqe prej 3359 m² ZK Astrazup, parcela kontestuese nr.01252-0, në vendin e quajtur “Nen Rrugë”, me kulturë “Arë e kl.8”, në sipërfaqe prej 1021 m² ZK Astrazup, parcela kontestuese nr.01396-0, në vendin e quajtur “Ara e Mes-Batallina”, me kulturë “Mal e kl.4”, në sipërfaqe prej 726 m² ZK Astrazup, parcela kontestuese nr.01397-0, në vendin e quajtur “Ara e Mes-Batallina”, me kulturë “Arë e kl.8”, në sipërfaqe prej 1032 m² ZK Astrazup, parcela kontestuese nr.01404-0, në vendin e quajtur “Ara Emes-Ara te Vidhet”, me kulturë “Kullosëe kl.5”, në sipërfaqe prej 250 m² ZK Astrazup, parcela kontestuese nr.01405-1, në vendin e quajtur “Ara Emes-Ara te Vidhet”, me kulturë “Arë e kl.7”, në sipërfaqe prej 3173 m² ZK Astrazup, parcela kontestuese nr.01405-2, në vendin e quajtur “Ara Emes-Ara te Vidhet”, me kulturë “Kullosë e kl.5”, në sipërfaqe prej 6123 m² ZK Astrazup, evidentohen në emër të H. M. dhe S. B. me pjesë ideale me nga 1/2.

Si fakte relevant në këtë çështje juridike, gjykata merr për bazë se është argumentuar fakti se paditësi është në posedim të ligjshëm dhe mirëbesim paraardhësit e të paditurve i kanë pranuar të hollat, dhe se të paditurit nuk ka kundërshtuar që paluajtshmëria të bartet në emër të paditësit.

Ligji për Pronësi dhe të Drejta tjera Sendore me dispozitën e nenit 40. 1 parasheh se: ***Personi i cili me mirëbesim e ka njëzetë (20) vjet në posedim të pandërprerë një paluajtshmëri ose një pjesë të saj, e fiton pronësinë në të***, sipas kësaj gjendje të vërtetuar gjykata vlerëson se paditësi në shfrytëzim të pronës është vendosur posedim të ligjshëm dhe mirëbesim rreth mbi 20 vite, i cili kusht është plotësuar edhe me LTHMPJ-së, sipas dispozitës së nenit 28. 4.

Në bazë të gjendjes faktike të cekur më lartë e duke u mbështetur në dispozitën e nenit 28. 4 të LTHMPJ-së, dhe nenit 40. 1 të Ligjit për Pronësi dhe të Drejta tjera Sendore, si dhe neneve 143 dhe 254 dhe 319 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është mbështetur në dispozitën e nenit 450 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË MALISHEVË
C.nr.199/21, më 16.01.2023**

**Gjyqtari
Betim Behluli**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa paraqitet nëpërmjet të kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit, Divizioni Civil në Prishtinë.